

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. _____ Rep. 1062
Nr. _____ Kol. 571

DEKLARATE NOTERIALE

Ne Tirane, sot me 15.02.2016, para meje noteres se Dhomes se Notereve Tirane, Majlinda E Demollari, Rr. V.Pasha, Ish bllok, anetare e Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten personalisht:

Z. Klevens Toka, i biri i Gjergjit dhe i Natashes, lindur me 01.06.1978, ne Tirane, banues Rr. "Hoxha Tahsin", nr 225, Tirane, mbajtes i leternjoftimit 024429777, me date skadence 23.02.2019 person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me vullnetin e tij te plote e te lire deklaroi:

"Une i nenshkruari Klevens Toka, deklaroi nen pergjegjesine time te plote, qe kam marre nje hua ne nje shume ne te holla prej 450.000 Euro (katerqind e pesedhete mije) Euro nga Znj. Natasha Xhai Toka, e bija e Spiros dhe e Krisanthit, lindur me Tirane, ne 29.10.1952, banuese Rr. "Durrësit", pall. 124, shk. 1, ap. 6, Tirane, Shqiperi, mbajtese e leternjoftimit 025333853, me date skadence 07.05.2019 dhe se marr persiper te shlyej shumen 450.000 Euro (katerqind e pesedhete mije) Euro brenda dates 31.03.2016.

Gjithashtu deklaroi nen pergjegjesine time te plote une Klevens Toka marr persiper te shlyej personalisht kete detyrim prej 450.000 Euro (katerqind e pesedhete mije) Euro ndaj Znj. Natasha Xhai Toka, per kete arsye jam dakort te bllokohen prane Regjistrimit te Barres Siguruese dhe Regjistrimit Tregtar, 25% kuota (pjesa) te zoteruara, vlera e kapitalit ne para 25.000,00 Lek qe une zoteroj ne shoqerine "Tirana Paper Provider" shpk, te regjistruar prane regjistrimit tregtar me numer NIPT L01720016F per kete detyrim. Keto kuota do te bllokohen sipas kontrates se huase me barre siguruese Nr. 7178 Rep dhe Nr.3283 Kol date 18.11.2014, te hartuar nga une Noteri Majlinda Demollari, deri ne momentin e shlyerjes se ketij detyrimit.

Deklaroi se jam dijeni qe kjo deklarate perben titull ekzekutiv, te zbatueshem kundrejt Natasha Xhai Toka ne perputhje me termat e saj. Me nenshkrimin e kesaj deklarate i jap te drejten Znj. Natasha Xhai Toka, qe ne rast te mospermbushjes se te ketij detyrimi, Znj. Natasha Xhai Toka ka te drejte te kerkoje nxjerrjen e urdherit te ekzekutimit ne gjykate, dhe /ose te ndermarre te gjitha veprimet ligjore per transferimin, trejtersimin apo shitjen e kuotave qe une zoteroj ne shoqerine "Tirana Paper Provider" shpk, te regjistruar prane regjistrimit tregtar me numer NIPT L01720016F, te renduara me barre siguruese sipas kontrates.

Une, Noteri i lexoj me ze te larte Z. Klevens Toka, tekstin e kesaj deklarate noteriale. Ajo me deklaroi se e kupton dhe se permbajtesja e saj perputhet plotesisht me theniet e tij, dhe e nenshkruan rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj kete Deklarate Noteriale sipas ligjit shqiptar.

Deklarues

Klevens Toka

KLEVENS TOKA

Toka

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pulles
Il Paqna

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIPT: K41600940A
Tel: 0682061560


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.Regj.Them. 3996

VENDIM
“PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: BLERINA MUÇA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Sadiku, në Tiranë, datë 14.06.2016, në seancë të hapur gjyqësore, mori në shqyrtim kërkesën civile me Nr. 3996 Akti, që i përket:

KËRKUESE: **Natasha Xhai (Toka)**, e bija e Spiros dhe e Krisanthit, e dtl. 29.10.1952, lindur dhe banuese në Tiranë, Rruga e Durrësit, pallati nr. 124, Shkalla 1, Ap. 6.

OBJEKTI: Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv *Deklaratë Noteriale* me Nr. 1062 Rep. Nr. 471 Kol. datë 15.02.2016.

BAZA LIGJORE: Nenet 510 dhe 511 të K.Pr.Civile.

Gjykata, pasi dëgjoi palën kërkuese, që kërkoi pranimin e kërkesës, shqyrtoi aktet shoqëruese,


VËREN

Pala kërkuese, Natasha Xhai (Toka), mbështetur në parashikimet e nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile, kërkon lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Deklaratën Noteriale me Nr. 1062 Rep. Nr. 471 Kol. datë 15.02.2016, të lëshuar nga debitori Klevens Toka.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kërkesës dhe akteve provuese, rezulton që në datën **15.02.2016**, shtetasi **Klevens Toka**, në cilësinë e debitorit, ka nënshkruar deklaratën noteriale të mësipër cituar, nëpërmjet së cilës deklaroi se, i detyrohet palës kërkuese, në shumën **450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) Euro**.

Në të njëjtën deklaratë, debitori ka deklaruar se, merr përsipër ta kthejë këtë shumë brenda datës **31.03.2016**. Po ashtu huamarrësi është shprehur se është dakort të bllokohen pranë regjistrit të Barrës Siguruese dhe Regjistrit Tregtar 25 % kuota (pjesë) të zotëruara, vlera e kapitalit në para 25.000,00 lekë që zotëron në shoqërinë “Tirana paper privider” shpk, të regjistruar pranë regjistrit tregtar me

numër NIPT L 01720016 F për këtë detyrim. Këto kuota do të bllokohen sipas kontratës së huasë me barrë sigurruese Nr. 7178 Rep. Nr. 3283 Kol. datë 18.11.2014, të hartuar nga noteri, deri në momentin e shlyerjes së këtij detyrimi.



Huamarrësi Klevens Toka, deklaron se në rast mospërmbushjes të këtij detyrimi, kërkuesja znj. Natasha Xhai Toka ka të drejtë të kërkojë nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit në gjykatë dhe/ose të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për transferimin, tjetërsimin apo shitjen e kuotave që zotëron në shoqërinë "Tirana paper provider" shpk, të rënduara me barrë sigurruese sipas kontratës.

Nga shqyrtimi i akteve ezulton se, marrëdhënia mes palëve, ka filluar që në datën 17.12.2005, nëpërmjet Kontratës së Huasë për shumën 450.000 Lekë, të marra nga Klevens Toka, me qëllim investimin në fushën e dnërtimit, pa interesa. Në datën 18.11.2014, po mes palëve rezultojnë të jetë nënshkruar Kontrata e Huasë me barrë sigurruese, me Nr. 7178 Rep. Nr. 3283 Kol. e cila rezultojnë e regjistruar në Regjistrin e Barrëve Sigurruese, si dhe në praktikën e shoqërisë "Tirana Paper Provider" shpk pranë QKR-së.

Nga spjegimet e kërkueses në seancë, nuk rezultojnë që shuma e mësipërme, të jetë shlyer nga debitori, edhe pse ka kaluar afati për të cilin palët kanë rënë dakort. Në referim të parashikimeve të nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile, përbëjnë titull ekzekutiv "...aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla,...".

Deklarata objekt shqyrtimi, në kushtet kur debitori Klevens Toka, ka marrë përsipër detyrimin në mënyrë të njëanshme dhe pa kushte, përbën në vetvete një deklaram të mëvetësishëm, të pavarur nga veprime juridike të mëparshme mes palëve. Në të njëjtin arsyetim, vjen dhe Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, me Nr. 980 datë 29.09.2000, në pjesën arsyetuese të të cilit, nxirret si konkluzion:

"Akti noterial si titull ekzekutiv, mund të përmbajë edhe një detyrim që buron nga një kontratë e mëparshme, apo, më gjerë, nga çdo veprim juridik tjetër i mëparshëm, ku debitori ka qënë palë. Ky detyrim i ri, që jo rrallë shuan detyrime të mëparshme, pasi merret përsipër nga debitori në mënyrë të njëanshme dhe pa kushte, fiton një ekzistencë të mëvetësishme e të pavarur."

Në kushtet kur debitori rezultojnë të ketë deklaruar në mënyrë të njëanshme ekzistencën e detyrimit të përcaktuar në shumën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) Euro ndaj kërkueses, duke mos e kushtëzuar këtë detyrim me një afat shlyerje të përcaktuar, në momentin e kërimit të shlyerjes së këtij detyrimi nga ana e kreditorit nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për shqyrtim, Gjykata vlerëson se Deklarata Noteriale objekt gjykimi, është kthyer në titull ekzekutiv.

Nisur nga sa më sipër, konform nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konkludon në pranimin e kërkesës së palës kërkuese Natasha Xhai Toka dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Deklaratë Noteriale, me Nr. 1062 Rep. Nr. 471 Kol. datë 15.02.2016, lëshuar nga debitori Klevens Toka, për shumën e pranuar në këtë deklaratë.



PËR KËTO ARSYE
Gjykata, në mbështetje të nenit 511/ç të K.Pr.Civile

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Deklaratën Noteriale me Nr. 1062 Rep. Nr. 471 Kol. datë 15.02.2016, të lëshuar nga huamarrësi **Klevens Toka**, për shumën **450.000** (katërqind e pesëdhjetë mijë) **Euro**.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ngarkohet Shërbimi Përmbarimor me ekzekutimin e titullit të mësipërm ekzekutiv.
- Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

Tiranë, më 14.06.2016

SEKRETARE

VALBONA SADIKU

Shpenzime gjyqësore
Taksë regj. kërkesë 200 Lekë

GJYQTARE

BLERINA MUÇA

